



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1911 / prot.,
2

Tiranë, më 04.07.2019

VENDIM

Nr. 31, datë 04.07.2019

PËR

MIRATIMIN E PAGESËS SË STUDENTËVE, QË PËRFITOJNË BURSË PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, QË STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, TË AKORDUAR NGA ORGANET E BASHKËQEVERISJES VENDORE, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë." e ndryshuar, si dhe në relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 1824/6, datë 28.06.2019. Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e bursës së plotë, studentes Artjola Qamil Boja, studente në Fakultetin e Mjekësisë, në masën 87,250 (tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, për vitin akademik 2018-2019.
2. Të miratojë pagesën e $\frac{1}{2}$ bursë, studentit Sontiljano Nazmi Gjoka, student në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, në masën 87,250 (tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, për vitin akademik 2018-2019.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë për zbatimin dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Institucionit.

**ZV KRYETARI
FLORIAN TOTI**

